



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 1447/Prot.

Tiranë, më 05.05.2026

VENDIM

Nr. 70, datë 21.04.2026

**“PËR TRANSFERIMIN E PROKURORIT ADNAN HOXHA NË PROKURORINË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM ELBASAN, NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES
PARALELE”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar (në mungesë)
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen plenare të datës 21.04.2026, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenet 18 dhe vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për transferimin e prokurorit Adnan Hoxha në Prokurorinë pranë Gjykatës së
Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nëpërmjet procedurës së
lëvizjes paralele”**

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 1447 prot., datë 07.04.2026, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoji Relatorin, z. Sokol Stojani, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, *“Për shpalljen e 23 (njëzet e tre) vendeve vakante për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele në prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe shpalljen e 3 (tre) vendeve vakante nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”*, Këshilli shpalli 23 (njëzet e tre) vendeve vakante në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Elbasan, Fier, Shkodër dhe Tiranë. Njëri ndër vendet e shpallura është pozicioni vakant nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
3. Të dhënat lidhur me subjektet që kanë të drejtë të kandidojnë, kushtet ligjore, afati deri kur pranohen aplikimet etj, janë njoftuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit në datë 20.02.2025.
4. Pas përfundimit të afatit të aplikimit në datë 06.03.2025, me Vendimin nr. 55, datë 27.03.2025, *“Për miratimin e listës së prokurorëve që kanë kandiduar nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele për vendet vakante në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të shpallura me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit”*, Këshilli ka miratuar listën e prokurorëve që kanë kandiduar për transferimin nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ndër të cilët edhe kandidatët për vendin vakant si më sipër.
5. Me Vendimin nr. 56, datë 27.03.2025, *“Për caktimin me short të relatorit për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për vendet vakante në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, të shpallura me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit”*, Këshilli caktoi nëpërmjet procedurës së hedhjes së shortit relatorët për secilin pozicion të shpallur. Për pozicionin vakant nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan u zgjodh si Relator z. Sokol Stojani.
6. Në cilësinë e Relatorit për pozicionin vakant nr. 2, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe në zbatim të neneve 11 pika 1 dhe 18, pika 1, të Vendimit nr. 261, datë 17.11.2020, *“Për miratimin e Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”*, e ndryshuar (në vijim Rregullorja), janë njoftuar kandidatët për këtë pozicion, në rrugë elektronike (me e-mail), në datë 31.03.2025 dhe 30.04.2025, për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit, si dhe për të drejtën për të kërkuar përjashtimin e relatorit, apo ndonjë anëtar i Këshillit, në rast të ekzistencës së një situatë konflikti interesi.

Meqenëse pas kalimit të këtij afati nuk ka pasur asnjë kërkesë për përjashtimin e relatorit, është filluar puna për verifikimin e plotësimit të kriterëve të vlerësimit nga ana

e kandidatëve, bazuar në nenin 43, të Ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar (në vijim, *Ligji për Statusin*), si dhe nenet 8, 15 dhe 21 të Rregullores.

7. Bazuar në nenin 43, pika 6, të Ligjit për Statusin dhe nenin 8, pika 1, të Rregullores *“Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”*, me Vendimin nr. 91, datë 14.05.2025, *“Për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të kandidatëve në procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për vendet vakante në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, shpallur me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit”*, pas verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit përfshirë edhe pozicionin vakant nr. 4, cituar më sipër, Këshilli ka vendosur miratimin e listës emërorë të kandidatëve që kanë aplikuar në procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për 23 (njëzet e tre) vende vakante në Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, shpallur me Vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit.
8. Me Vendimin nr. 204, datë 25.07.2025, *“Për renditjen e kandidatëve të kualifikuar në procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin vakant Nr.2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin nr. 27, datë 14.02.2025, të Këshillit”*, Këshilli miratoi renditjen e kandidatëve në garë për pozicionin nr. 2 vakant në zyrën e Prokurorisë Elbasan, si vijon:
 1. Adnan Hoxha;
 2. Olliana Gjergjeft;
 3. Albulena Kuliçi;
 4. Alisa Spahja.
9. Vendimi i është njoftuar kandidatëve në datë 01.08.2025 nga Sektori i Protokollit dhe Arkivit pranë Këshillit dhe deri në datën e paraqitjes së Relacionit nga ana e Komisionit nuk është administruar në institucion asnjë ankim në kuptim të nenit 22, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 261, datë 17.11.2020, Rregullore *“Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”*, i ndryshuar (në vijim *Rregullorja*).
10. Në këto kushte, nisur nga renditja e miratuar sipas vendimit të sipërcituar, Komisioni i propozoi Këshillit transferimin e kandidatit Adnan Hoxha në pozicionin vakant nr. 2, në zyrën e Prokurorisë Elbasan nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, bazuar në nenin 45, pika 1, të Rregullores.
11. Kandidati Adnan Hoxha, është caktuar në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, me Vendimin nr. 43, datë 11.02.2020, *“Për emërimin si prokuror dhe caktimin në detyrë të z. Adnan Hoxha”*, të Këshillit. Nga dosja personale rezulton se deri në datë 14.02.2025, ka 5 (pesë) vite vjetërsi pune si magjistrat, të gjitha përvojë profesionale specifike në atë shkallë për të cilën kandidon.

12. Sa i takon hyrjes në fuqi të aktit dhe krijimit të pasojave, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë në kushtet kur, para faktit të sigurimit të një kalimi të detyrës në mënyrë graduale, Komisioni iu referuar nenit 104, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, ku përcaktohet se:

“1. Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve.

2. Akti administrativ i miratuar në heshtje fillon të sjellë pasoja juridike, në ditën e përfundimit të afatit për njoftimin e tij, sipas nenit 97 të këtij Kodi.

3. Një akt administrativ mund të fillojë të sjellë pasoja juridike në një datë tjetër, të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë rast përpara njoftimit të palës, sipas pikës 1 të këtij neni. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave juridike caktohet shprehimisht në pjesën e dispozitivit të aktit administrativ të shkruar.

4. Një akt administrativ sjell pasoja juridike:

a) për sa kohë nuk është anuluar apo shfuqizuar, kryesisht apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve ligjore administrative ose gjyqësore;

b) për sa kohë nuk ka përfunduar afati i aktit ose nuk është përmbushur qëllimi i tij; ose

c) për çfarëdo arsyeje tjetër të parashikuar nga ligji.”

13. Referuar sa më sipër, pasojat juridike të aktit administrativ dhe fillimi i ushtrimit të detyrës efektive në zyrën e prokurorisë pritëse, në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të Prokurorisë, do të krijohen në një moment të dytë, konkretisht në datë 04.05.2026.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 42 dhe 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 104, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 45, të Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele”, e ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Transferimin e prokurorit Adnan Hoxha në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, nëpërmjet lëvizjes paralele.
2. Marrëdhëniet financiare që lidhen me pagën dhe përfitimet e tjera do të përballohen nga Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan duke filluar nga data 04.05.2026.
3. Të njoftohen për këtë vendim prokurori Adnan Hoxha, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 21.04.2026.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË


KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erion Fejzulla

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Olger Eminaj